

Antipsikotikët atipik në trajtim të Depresionit refraktar -rishikim i literaturës

Dr.Sh.Statovci, Dr.V.Alidema-Serreqi, Dr.V.Tafilaj, Dr.M.Kurmehaj, S.Brainia.T.Tahiri

Hyrje: Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO), 350 milionë njerëz në mbarë botën vuajnë nga depresioni. Personat e prekur me depresion përballen me reduktim të ndjeshëm të kualitetit të jetës, dëmtim të aftësisë për punë dhe dëmtim të shëndetit në përgjithësi, përderisa shoqëria ka kosto të konsiderueshme ekonomike. Pasi të diagnostikohet, një person me depresion mund të trajtohet me medikamente dhe psikoterapi. Përkundër që medikamentet antidepressive janë trajtime efektive për trajtim të depresionit, raportohet se rreth 30% deri në 45% të pacientëve që janë në trajtim shfaqin një përgjigje të pjesshme ose janë refraktar në trajtim. Kështu për të lehtësuar simptomat e depresionit të rastet refraktare janë të domosdoshme edhe opsione tjera të trajtimit, në punimin tonë flitet për përdorimin i antipsikotikëve atipik.

Metodat: Studimet u identifikuan duke përdorur kërkimet përmes rishikimit të literaturës që trajton strategji tjera të trajtimit të depresionit refraktar me fokus të vecantë në përdorimin e antipsikotikëve atipik si opsion në trajtim. Kërkimet u realizuan duke përdorur termin depresion dhe depresion refraktar bashkë me termet në vijim si: risperidone, olanzapine, clozapine, quetiapine, ziprasidone dhe aripiprazole.

Rezultatet: Pas raporteve fillestare pozitive, raporteve të shkurtra dhe studimeve klinike, studimet më të mëdha nuk arritën të tregojnë efektivitetin e antipsikotikëve atipik kombinuar me antidepressantë për trajtimin e depresionit refraktar. Kohët e fundit, gjykimet klinike në shkallë më të gjerë kanë mbështetur efektivitetin e të paktën disa prej këtyre medikamenteve. Ndërsa antipsikotikët atipik kanë fituar në popullaritet për trajtimin e depresionit rezistent, duhet të jemi të kujdesshëm për efektet anësore, shqetësimet janë kryesisht të ndërlidhura me rreziqet të tilla si sindromi metabolik dhe diskinezia tardive.

Përfundim: Hulumtimet ekzistuese ofrojnë mbështetje për efektet e dobishme të antipsikotikëve atipik në trajtim të depresionit refraktar, mirëpo për shkak që këto medikamente paraqesin rreziqe të rëndësishme që duhet të merren parasysh në përdorimin e tyre hulumtime të mëtejshme janë të nevojshme.

Atypical antipsychotics in the treatment of Refractory Depression - Literature review

Dr.Sh.Statovci, Dr.V.Serreqi, Dr.V.Tafilaj, Dr.M.Kurmehaj, S.Brainia, T.Tahiri

Introduction: According to the World Health Organization (WHO), 350 million people worldwide suffer from depression. Depressed persons are faced with a significant reduction in quality of life, impairment of work ability and overall health damage, while society there are considerable economic costs. Once diagnosed, a depressed person can be treated with medication and psychotherapy. Despite the fact that antidepressant drugs are effective treatments for depression treatment, it is reported that about 30% to 45% of patients undergoing treatment exhibit a partial response or are refracted into treatment. To alleviate the symptoms of depression in refractory cases, other treatment options are also necessary, in our paper we talking about use of the atypical antipsychotics.

Methodology: Studies were identified using research through literature review that addresses other refractory depression treatment strategies with a particular focus on the use of atypical antipsychotics as an option in treatment. Research was conducted using term depression and refractory depression along with the following terms: risperidone, olanzapine, clozapine, quetiapine, ziprasidone and aripiprazole.

Results: After initial positive reports, short reports and clinical studies, major studies failed to demonstrate the effectiveness of atypical antipsychotics combined with antidepressants for the treatment of refractory depression. Recently, clinical trials on a broader scale have supported the effectiveness of at least some of these medications. While atypical antipsychotics have gained popularity in treating resistant depression, we need to be careful about side effects, concerns are mainly related to dangers such as metabolic syndrome and tardive dyskinesia.

Conclusion: Existing researches provides support for the beneficial effects of atypical antipsychotics in the treatment of refractory depression, but because these medications pose significant risks that need to be considered in their use further research is needed.